

1 E hënë, 9 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitja e parë]

4 [I akuzuari Kilaj hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 13.00

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëdita, dhe mirë se
7 erdhët të gjithë në këtë seancë të Paraqitjes së Parë.

8 Znj. Sekretare, ju lutem, paraqisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar
10 Gjykatëse. Çështja KSC-BC-2023-12, Prokurorja e Specializuar
11 kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil
12 Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.
14 Sekretare.

15 Përpara se të fillojmë, dua t'i jap fotografit mundësinë
16 për të bërë disa fotografi.

17 Urdhëroni, z. Fotograf.

18 Faleminderit, z. Fotograf.

19 Përpara se t'ju kërkoj të pranishmëve në sallë që të
20 prezantohen, ju kujtoj të gjithëve rregullat që duhet të
21 respektohen gjatë gjithë kohës për të siguruar ecurinë e
22 papenguar të kësaj seance.

23 Ju lutem, ndizeni mikrofonin përpara se të filloni të
24 flisni dhe fikeni sapo të keni përfunduar. Flisni ngadalë dhe
25 qartë duke qenë se kemi përkthim në dhe prej shqipes dhe

1 serbishtes. Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni
2 mua ose palës tjetër, për t'ju mundësuar përkthyesve të
3 përfundojnë përkthimin.

4 Gjithashtu, u kujtoj të gjithëve se një pjesë e
5 informacionit në këtë çështje është konfidencial. Informacioni
6 konfidencial nuk nxirret në seancë të hapur. Nëse palët
7 dëshirojnë të diskutojnë ose t'i referohen informacionit
8 konfidencial, duhet të kërkojnë të kalojmë në seancë private.

9 Tani, do t'u kërkoj palëve të prezantohen duke filluar me
10 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëdita. Joshua Hafetz, në emër të
12 Prokurorisë. Dhe me mua sot janë Prokurorja e Specializuar,
13 Kimberley West e ulur pas meje; z. Sullivan në të majtë, dhe
14 znj. Eleonore Coeuret pas tij.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

16 Tani për Mbrojtjen.

17 Z. EDWARDS: [Përkthim] Mirëdita. Unë jam Iain Edwards nga
18 Anglia.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Për hir të
20 procesverbalit, theksoj se dhe klienti juaj z. Kilaj, është i
21 pranishëm në sallë.

22 Tani e ka radhën Zyra Administrative.

23 Z. NILSSON: [Përkthim] Unë jam Jonas Nilsson,
24 Zëvendësadministrator dhe me mua është Whitney Price.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Dhe së fundi për

1 procesverbalin, unë jam Marjorie Masselot, Gjykatësja e
2 Procedurës Paraprake në këtë çështje.

3 I akuzuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të
4 Specializuara pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij më 29
5 nëntor 2024.

6 Z. Kilaj, çohuni në këmbë, ju lutem. Ju lutem, ndizni
7 mikrofonin dhe përgjigjuni në pyetjet në vijim.

8 Ju lutem, na jepni emrin dhe mbiemrin, dhe vendin e
9 lindjes.

10 I AKUZUARI KILAJ: Isni Kilaj, vendlindja Lubizhdë, komuna
11 Malishevë. Data e lindjes, 19.12.1963.

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Dhe gjithashtu a mund të
13 na thoni se çfarë nënshtetësie apo nënshtetësish keni, nëse
14 janë më shumë?

15 I AKUZUARI KILAJ: Nënshtetësia e Kosovës.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Dhe profesioni juaj
17 aktual?

18 I AKUZUARI KILAJ: Ekonomist i diplomuar, i papunë.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.
20 Përpara se të vazhdojmë, dua të sigurohem se mund ta ndiqni
21 procedurën në gjuhë që e kuptoni dhe e flisni. A mund të më
22 konfirmoni, ju lutem, se e kuptoni dhe flisni gjuhën shqipe?

23 I AKUZUARI KILAJ: Po.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

25 Me këtë konfirmim jam bindur se mund t'i ndiqni procedurat në

1 shqipe si gjuhën që e kuptoni dhe flisni, në përputhje me
2 rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

3 Në qoftë se në ndonjë moment gjatë kësaj seance nuk keni
4 përkthim, ju lutem të ma bëni me dije këtë menjëherë.

5 Z. Kilaj, tani mund të uleni. Dhe, ju lutem, fikni
6 mikrofonin.

7 Tani do të paraqes shkurtimisht historikun procedural që
8 i paraprin kësaj seance të paraqitjes së parë.

9 Më 29 nëntor 2024, unë si Gjykatëse e Procedurës
10 Paraprake, konfirmova pjesërisht aktakuzën e dorëzuar nga
11 Prokurorja e Specializuar kundër z. Thaçi, z. Bashkim Smakaj,
12 z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu dhe z. Hajredin Kuçi, në të
13 cilën z. Kilaj i ngarkohet një akuzë për tentativë për pengim
14 të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të
15 pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi dhe një
16 akuzë për mosbindje ndaj Gjykatës.

17 Gjithashtu, lëshova fletarrestimin për z. Kilaj po atë
18 ditë.

19 Më 5 dhjetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar
20 arrestoi z. Kilaj në Kosovë dhe atij iu dorëzuan
21 fletarrestimi, Aktakuza e Konfirmuar dhe vendimi për lëshimin
22 e fletarrestimit të përkthyer në gjuhën shqipe.

23 Më 6 dhjetor 2024, z. Kilaj u transferua në objektin e
24 paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.
25 Po atë ditë unë lëshova vendimin për caktimin e ditës së sotme

1 për mbajtjen e kësaj seance të paraqitjes së parë. Rikujtoj se
2 u miratua kërkesa për ndryshimin e orës dhe datës së seancës,
3 dhe prandaj seanca mbahet në këtë orë dhe në këtë datë.

4 Tani, më lejoni t'ju rikujtoj qëllimin konkret të
5 paraqitjes së parë për nevojat e z. Kilaj.

6 Z. Kilaj, seanca e sotme nuk është gjykim. Nuk do të
7 paraqiten dhe as do të debatohen prova, dhe nuk do të
8 diskutohet fajësia apo pafajësia juaj, e as nuk do të merret
9 vendim në lidhje me të.

10 Qëllimi i paraqitjes së parë përcaktohet në nenin 39(5)
11 të Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores. Në pajtim me këto
12 dispozita unë si Gjykatëse e Procedurës Paraprake:

13 Ia lexoj të akuzuarit akuzat e paraqitura në Aktakuzën e
14 Konfirmuar;

15 Konfirmoj se i akuzuari e kupton aktakuzën;

16 Bindem se të drejtat e të akuzuarit dhe veçanërisht e
17 drejta e tij për të pasur Avokat mbrojtës janë respektuar;

18 Dhe informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita e
19 seancës së sotme ai do të ftohet të deklarohej fajtor ose i
20 pafajshëm në lidhje me secilën akuzë të paraqitur në aktakuzë.

21 Në qoftë se i akuzuari dëshiron, ai mund edhe menjëherë të
22 vetëdeklarohej në lidhje me fajësinë apo pafajësinë.

23 Dhe në fund, caktoj data të tjera sipas nevojës në
24 kryerjen e detyrave të mia si Gjykatëse e Procedurës
25 Paraprake.

1 Këto janë pikat që do të trajtohen një nga një në seancën
2 e sotme të paraqitjes së parë. Nëse palët dëshirojnë të
3 diskutojnë ndonjë aspekt tjetër që nuk është paraparë
4 shprehimisht në kontekst të kësaj Paraqitje të Parë, i ftoj
5 palët që këtë ta bëjnë nëpërmjet paraqitjeve me shkrim.

6 Së pari, z. Kilaj, ju lutem, çohuni në këmbë.

7 A mund të më konfirmoni se e keni marrë Aktakuzën e
8 Konfirmuar në një gjuhë që e kuptoni dhe e flisni? Ju lutem,
9 mos harroni ndizni mikrofonin.

10 I AKUZUARI KILAJ: Po.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

12 Përpara se sa Sekretarja t'i lexojë Akuzat e Konfirmuara
13 kundër jush, dua t'ju rikujtoj se ky nuk është momenti për t'i
14 kundërshtuar akuzat, por thjesht për të konfirmuar se i
15 kuptoni ato. Do të keni mundësi për t'i kundërshtuar akuzat me
16 ndihmën e avokatit mbrojtës.

17 Tani do t'i kërkoj Sekretares së Gjykatës t'i lexojë
18 akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar sikurse
19 parashihet në nenin 39(5) të Ligjit dhe rregullën 92(2)(b) të
20 Rregullores.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

22 1. Në Aktakuzën e Konfirmuar Prokuroria e Specializuar
23 akuzon z. Kilaj për:

24 Pika 14: Tentativë për pengim të personave zyrtarë,
25 veçanërisht prokurorët dhe hetuesit e ZPS-së, në kryerjen e

1 detyrave zyrtare me anë të pjesëmarrjes në veprimin e
2 përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të nenit
3 401(2) dhe (5) të Kodit Penal të vitit 2019, dhe nenit 15(2)
4 të Ligjit, dhe

5 Pika 15: Mosbindje ndaj gjykatës, e ndëshkueshme në bazë
6 të nenit 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, dhe
7 nenit 15(2) të Ligjit.

8 2. Këto vepra penale u kryen midis së paku 6 tetorit dhe
9 2 nëntorit 2023.

10 3. Në lidhje me këto vepra penale, ekziston dyshimi i
11 bazuar mirë se z. Isni Kilaj mban përgjegjësi penale, në bazë
12 të nenit 16(3) të Ligjit për:

13 a. Kryerje të veprës penale të tentativës së pengimit të
14 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Pikës
15 14, në bazë të nenit 17 të Kodit Penal të Kosovës të vitit
16 2019.

17 b. Ndhimë dhënë z. Hashim Thaçi në kontekst të grupit në
18 kryerjen e veprës penale të tentativës së pengimit të
19 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas Pikës
20 14, në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit
21 2019

22 c. Ndhimë dhënë z. Thaçi në kryerjen e veprës penale të
23 mosbindjes ndaj Gjykatës sipas Pikës 15, në bazë të nenit 33
24 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, dhe

25 d. Marrëveshje për kryerje me z. Hashim Thaçi në kontekst

1 të grupit në kryerjen e veprës penale të tentativës së
2 pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare
3 sipas Pikës 14, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal të Kosovës
4 të vitit 2019.

5 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.

7 Sekretare.

8 Z. Kilaj, a i kuptuat akuzat e paraqitura në aktakuzën e
9 konfirmuar sikurse u lexuan prej Sekretares së Gjykatës?

10 I AKUZUARI KILAJ: Po.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

12 Mund të uleni.

13 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e
14 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë ju, z. Kilaj, disa të
15 drejta. Dhe unë do t'i lexoj ato më të rëndësishmet.
16 Konkretisht, ato që janë relevante për këtë fazë të procesit.

17 Do të prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e
18 fajësisë tuaj përtej dyshimit të arsyeshëm.

19 Në marrjen e vendimit mbi akuzat kundër jush, ju keni të
20 drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik në varësi të
21 çfarëdo mase të urdhëruar për mbrojtjen e viktimave dhe të
22 dëshmitarëve.

23 Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe në hollësi në
24 një gjuhë që e kuptoni për natyrën dhe arsyet e akuzave kundër
25 jush.

1 Keni të drejtën për të pasur kohë dhe mundësi të
2 mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes suaj si dhe për të
3 komunikuar me Avokatin mbrojtës që keni zgjedhur vetë.

4 Keni të drejtën të gjykoheni brenda një periudhë kohore
5 të arsyeshme, keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj
6 dhe të mbroheni nëpërmjet Avokatit tuaj mbrojtës.

7 Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat mbrojtës si
8 dhe pa pagesë në qoftë se nuk keni -- dispononi mjetet të
9 mjaftueshme për pagesën e shpenzimeve të Avokatit.

10 Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi falas nëse
11 nuk e kuptoni dhe flisni gjuhën që përdoret në Gjykatë.

12 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër
13 vetes apo të pranoni fajësinë.

14 Keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe nuk do nxirret
15 përfundim negativ nga heshtja juaj.

16 Dhe, keni të drejtën që të mos mbaheni në paraburgim për
17 periudhë të paarsyeshme kohore para hapjes së çështjes kundër
18 jush, të kërkonit rishqyrtimin e vendimeve mbi paraburgimin
19 tuaj si dhe të apeloni ato vendime drejtpërdrejt në Gjykatën e
20 Apelit.

21 Z. Kilaj, ju lexova të drejtat më të rëndësishme që
22 gëzoni në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të Dhomave të
23 Specializuara. A i kuptoni këto të drejta?

24 I AKUZUARI KILAJ: Po.

25 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

1 Gjithashtu dua t'ju informoj se sipas nenit 21(5) të
2 Ligjit, ju nuk mund të vetëpërfaqësoheni, sepse aktualisht
3 jeni në paraburgim. Prandaj, përfaqësimi prej Mbrojtësit të
4 Specializuar është i detyrueshëm.

5 Vërej se përfaqësoheni nga avokati Edwards dhe
6 rrjedhimisht jam bindur se i akuzuari aktualisht përfaqësohet
7 nga një avokat mbrojtës.

8 Tani do të kaloj tek e drejta e akuzuarit që të
9 vetëdeklarohet menjëherë në qoftë se dëshiron në përputhje me
10 rregullën 92 të Rregullores.

11 Z. Kilaj, brenda 30 ditësh nga dita e seancës së sotme,
12 do të ftoheni të vetëdeklaroheni fajtor ose i pafajshëm në
13 lidhje me akuzat në aktakuzë. Në qoftë se dëshironi, mund të
14 zgjidhni që menjëherë të pranoni fajësinë ose të
15 vetëdeklaroheni i pafajshëm.

16 Prandaj do t'ju pyes, z. Kilaj, nëse keni pas mundësinë
17 t'i diskutoni akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar me
18 Avokatin Mbrojtës dhe nëse jeni i gatshëm të vetëdeklaroheni
19 në lidhje me fajësinë ose pafajësinë në këtë moment sot.

20 I AKUZUARI KILAJ: Po. Do të deklarohe.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Urdhëroni.

22 I AKUZUARI KILAJ: Deklarohem plotësisht i pafajshëm.

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Kjo është në
24 procesverbal, z. Kilaj. Dhe meqë jeni deklaruar i pafajshëm,
25 për të gjitha pikat e akuzës, procedura paraprake do të

1 vazhdojë drejt përgatitjes së çështjes për gjykim në përputhje
2 me rregullën 95 të Rregullores.

3 Mund të uleni.

4 I AKUZUARI KILAJ: Faleminderit.

5 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani do të kalojmë tek
6 gjuhët e punës së këtij procesi. Në vendimin për caktimin e
7 datës së kësaj seance të paraqitjes së parë, unë ftova palët
8 që bëjnë parashtrime gojore në seancën e sotme në lidhje me
9 gjuhën e punës që do të përdoret në këtë çështje gjyqësore në
10 përputhje me rregullën 8 të Rregullores.

11 A mundeni, ju lutem palëve që të tregojnë se çfarë gjuhe
12 preferojnë të përdorin për proces, do të fillojmë me
13 Prokurorinë.

14 Z. HAFETZ: [Përkthim] Anglishtja.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

16 Mbrojtja?

17 Z. EDWARDS: [Përkthim] Po, anglishtja.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Do të
19 nxjerr vendimin në lidhje me këtë në kohën e duhur.

20 Në vendimin që përmenda, thashë se kam ndërmend që të
21 caktoj datën e Konferencës së Ecurisë së Çështjes, për datën
22 17 dhjetor 2024, e martë në orën 14.00. Gjithashtu, ju kërkova
23 që të paraqisni sot parashtrime me gojë në qoftë se keni
24 ndërmend të merrni pjesë në këtë Konferencë për Ecurinë e
25 Çështjes personalisht me prani fizike apo me anë të

1 videolidhjes.

2 Urdhëroni, z. Edwards.

3 Z. EDWARDS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

4 Edhe unë dhe klienti im do të jemi të pranishëm fizikisht

5 këtu.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

7 Tani i drejtohem Prokurorit. Edhe pse keni thënë që do të

8 jeni i disponueshëm, për hir të procesverbal duhet t'ju pyes

9 përsëri.

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Për të pestën herë, e nderuar

11 Gjykatëse, do të jemi të disponueshëm dhe do të jemi aty në

12 atë datë.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

14 Në urdhrin për caktimin e datës së asaj konference, do të

15 jap edhe udhëzimet në lidhje me pjesëmarrjen në atë seancë

16 përmes videolidhjes nëse është e nevojshme.

17 Tani në lidhje me paraburgimin e z. Kilaj.

18 Ju rikujtoj z. Kilaj se në bazë të konstatimit të

19 ekzistencës së dyshimit të bazuar mirë se keni kryer veprat

20 penale që ju ngarkohen, u lëshua një fletarrestim për ju me

21 datën 29 nëntor 2024.

22 Në bazë të nenit 41(6)(b), arrestimi juaj u vlerësua i

23 domosdoshëm për shkak se ekzistonin arsye të artikulueshme për

24 të besuar se ekzistonte rreziku i arratisjes, se mund të

25 pengonit ecurinë e procesit dhe se mund të përsëritni veprat

1 penale. Dhe këto dokumente u përkthyen në shqip së bashku me
2 Aktakuzën e Konfirmuar.

3 Tani, do t'ia jap fjalën Mbrojtjes në qoftë se dëshiron
4 të bëjë parashtrime në lidhje me çështjen e paraburgimit.

5 Z. EDWARDS: [Përkthim] Po. Gjithsesi që dua të bëj
6 parashtrime në lidhje me paraburgimin.

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Atëherë, urdhëroni, e
8 keni fjalën.

9 Z. EDWARDS: [Përkthim] Dua të filloj duke kërkuar që të
10 konfirmoj që përkthyesit kanë një kopje të fjalimit tim.

11 Faleminderit.

12 Personalisht ju falënderoj, z. Gjykatëse, për shtyrjen e
13 seancës së sotme, sepse nuk u desh që të udhëtoj në fundjavë.
14 Faleminderit.

15 E nderuar Gjykatëse, ju keni konstatuar gjatë konfirmimit
16 të aktakuzës kundër z. Kilaj që ekzistonte dyshimi i bazuar
17 mirë se z. Kilaj është penalisht përgjegjës për dy pika me të
18 cilat përballet në aktakuzë. Dhe është e arsyeshme për atë që
19 kriteri i dyshimit të bazuar që kërkohet për urdhërimin e
20 paraburgimit sipas nenit 41(6) të Ligjit, është plotësuar.

21 Dhe ju siguroj, e nderuar Gjykatëse, që nuk do të harxhoj
22 kohë këtë pasdite duke u përpjekur të argumentoj që keni
23 gabuar në konstatimin për dyshimin e bazuar mirë. Nuk është
24 parashtrimi im sot.

25 Ajo që do bëj, megjithatë, do të përqendrohem në mënyrën

1 se si dallimi teknik dhe ligjor mes dyshimit të bazuar dhe
2 dyshimit të bazuar mirë, në fakt, në realitet nuk përbën një
3 dallim kaq të qartë sipas mendimit të z. Kilaj, që rreziku i
4 sjelljes së tij tani do të ndryshonte në mënyrë kaq thelbësore
5 nga sjellja e tij e mëhershme, përgjatë shtatë muajve të
6 mëparshëm, e vërtetuar kjo sjellje që nga momenti, pra, kur
7 është liruar në Kosovë.

8 E nderuar Gjykatëse, z. Kilaj ka qenë, ka treguar që
9 është gjithmonë kandidat i sigurt dhe i mirë për lirimin me
10 kusht. Ai ishte, u tregua kandidat i mirë dhe i sigurt për
11 lirim me kusht para 13 muajsh kur ishim në këtë sallë gjyqi
12 herën e fundit më 4 nëntor 2023. Në atë kohë i parashtrova
13 Gjykatësit të Vetëm se z. Kilaj mund t'i besojë dhe mund të
14 lirohej me kusht, me kushte, me gjithë kundërshtimet e
15 Prokurorisë bazuar në baza të qarta të arsyeshme për të besuar
16 se ekzistonte rreziku i ikjes, rreziku i pengimit të
17 procedurës dhe rreziku i përsëritjes së veprës penale.

18 Në kllapa, më lejoni të them që edhe pse këto janë të
19 ndryshme, për qëllime të seancës së sotme, ka baza të
20 përbashkëta, rreziku i përsëritjes së veprës penale
21 përqendrohet, bazohet në të njëjtat vlerësime dhe për këtë do
22 të, që të jem sa më i shkurtër dhe të përqendrohem në
23 parashtrimet e mia tek pengimi i procedurës.

24 Në nëntor, vitin e kaluar, Gjykatësi i Vetëm nuk ishte i
25 bindur që t'i jepte z. Kilaj avantazhin e dyshimit, pra që në

1 nëntor vitin e kaluar z. Kilaj ishte njeri i panjohur. Nuk
2 ishte vënë në test, në provë. Atij nuk i ishte dhënë mundësia
3 të vërtetonte që mund t'i besohej atij me lirimin me kusht.

4 Dhe sipas mendimit të Gjykatësit të Vetëm, pasojat e
5 marrjes së një rreziku të tillë ishin, ishin të mëdha, tepër
6 të mëdha dhe ishte e preferueshme, më e sigurt ndoshta, do të
7 fitonim më shumë kohë, që të urdhërohej që z. Kilaj të mbahej
8 në paraburgim. Dhe kështu ndodhi dhe kjo situata vazhdoi deri
9 më 3 maj të këtij viti.

10 Për arsye të cilat ju i njihni shumë mirë, znj.
11 Gjykatëse, Gjykatësi i Vetëm vendosi, që me gjithë rreziqet
12 ekzistuese, kjo nuk ishte më proporcionale apo e arsyeshme
13 sipas kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores që të zgjaste
14 paraburgimin e z. Kilaj.

15 Dhe kjo ndryshoi gjithçka.

16 Me gjithë shqetësimet konkrete se z. Kilaj, në rast se
17 lirohej, mund të ikte, me gjithë shqetësimet konkrete se ai
18 mund të pengonte procedurën, të përfshihej në ndërhyrje,
19 përfundimisht pas muajsh paraburgim ai, atij i u dha mundësia
20 të vërtetonte se mund t'i besohej atij. Atij iu dha mundësia
21 të vërtetonte se shqetësimet e mëhershme dhe dyshimet,
22 rezervat, e mëhershme ishin të pavend. Dhe në fakt ato ishin
23 të pavend që nga nëntori 2023.

24 Dhe pas lirimit të tij në Kosovë, z. Kilaj e vërtetoi, e
25 shpërbleu këtë besim. Me veprimet e tij e shpërbleu këtë

1 besim, këto nuk janë vetëm fjalët e mia si Avokat i tij, por
2 veprimet e tij treguan se Gjykatësi i Vetëm kishte patur
3 absolutisht të drejtë që t'i jepte këtë mundësi.

4 Në poshtëshënimin 78 të vendimit tuaj, "Vendimi mbi
5 Kërkesën për Fletarrestimin dhe Çështjet që Lidhen me to", të
6 datës 29 nëntor 2024, ju konstatoji se nuk ka informacion në
7 dosjen e lëndës që vërteton se z. Kilaj nuk ka përmbushur
8 ndonjë nga kushtet që i janë imponuar, caktuar, atij. Dhe në
9 fakt kjo është tërësisht e vërtetë, por unë do të thoja që
10 këtë mund ta vëmë, ta paraqesim në mënyrë edhe më pozitive.
11 Mund t'i japim z. Kilaj më shumë merita për këtë.

12 Të gjitha dëshmitë në dosjen e lëndës tregojnë se ai ka
13 qenë absolutisht, plotësuar në mënyrë absolute kushtet me
14 besnikëri, në tërësi dhe çdo fjalë të kushteve që i janë
15 caktuar atij, pa dështuar asnjëherë në 7 muajt e fundit. Ai ka
16 jetuar dhe ka fjetur në adresën që i ka komunikuar Dhomave të
17 Specializuara çdo ditë, pa dështuar. Është paraqitur në
18 stacionin e policisë vendor çdo javë, pa munguar asnjëherë.

19 Dua të rrimë në seancë publike, por duhet t'ju them se
20 nuk ka bërë asgjë që atij i ishte ndaluar të bënte.

21 Ka qëndruar në territorin e Kosovës. Dhe, e nderuar,
22 Gjykatëse, ju kujtohet se kur ka dashur të shkojë në Shqipëri
23 vetëm disa ditë me gruan e tij, për të kërkuar pak kohë bashkë
24 në një vend që është shumë i dashur për ta, pas atij viti të
25 tmerrshëm që nga nëntor i vitit 2023, atij vitit të tmerrshëm

1 që kishin përjetuar, kur ai deshi të largohej nga Kosova, ai
2 bëri atë që pritej të bënte. Ai bëri atë që i ishte kërkuar,
3 që ishte urdhëruar të bënte.

4 Nuk shkoi në Shqipëri thjesht pa -- në mënyrë të
5 pakujdesshme, apo të pa rregullt. Por kërkoi fillimisht
6 autorizimin tuaj. Dhe, edhe pse ai u zhgënjye nga vendimi
7 juaj, ai e respektoi vendimin tuaj.

8 Nuk po them që z. Kilaj meriton që të duartrokasim sepse
9 respektoi kushtet. Ai bëri atë që Gjykata e kishte urdhëruar
10 të bënte siç duhej të bënte çdokush. Siç do duhej të bënte çdo
11 person. Pra, nuk po kërkoj që t'i jepet merita për këtë.

12 Por arsyeja për të cilën është e rëndësishme kjo, është
13 sepse pas shtatë muajsh, kjo Gjykatë nuk mund të thojë më që
14 z. Kilaj është person i panjohur. Nuk mund të thuhet më që ai
15 nuk ka një bilanc të cilin mund ta përdorë, të cilit mund t'i
16 referohet për të thënë që: Shikoni, kur më besuat e dini që e
17 meritoj këtë besim. Kam, jam i denjë për besimin që keni në
18 mua.

19 Kjo tani më sjell tek ajo që thotë ZPS-ja, ZPS-ja thotë
20 që situata, gjendja tani është tërësisht ndryshe. Tërësisht
21 ndryshe nga situata, gjendja që ishte para një jave. Dhe në
22 fakt kjo situatë është kaq ndryshe që bilanci i sjelljes së
23 tij të mëparshme duhet të lihet mënjanë, tërësisht, dhe se
24 personi që ka vërtetuar besimin e tij nuk mund t'i besohet më
25 këtij personi. Pra dhe pse ka vërtetuar se meriton këtë besim.

1 Unë parashtroj që kjo është qëndrim tërësisht i padrejtë.

2 Në fakt, në realitet, bëj pyetje retorike, sa, si qenka
3 ndryshe kjo situata tani, sa e ndryshme është kjo?

4 Së pari, lidhur me sugjerimin se -- kemi faktin, fakti i
5 ri që është konfirmimi i aktakuzës dhe fillimi i procedurës
6 paraprake. Po bëj një pushim këtu për të thënë që këto nuk
7 janë faktorë të pavarur autonomë. Nuk janë të ndryshëm. Në
8 fakt janë të njëjtët si faktori i tretë që u theksua nga
9 Prokuroria, sipas së cilës z. Kilaj tani përballet me
10 perspektivën më konkrete të një dënimi me burg afatgjatë.

11 Qëndrimi im është, parashtrimi është, që këto nuk janë të
12 ndara këto tre gjëra. Të gjitha burojnë nga i njëjti gjë. Ai
13 ishte në procedurën, është në procedurën paraprake, pastaj do
14 të përballet me gjykimin dhe mundësisht edhe me dënim.

15 Kjo është, natyrisht që është zhvillim, por do të ishte e
16 gabuar sipas parashtrimit tim që të mbivlerësohet rëndësia e
17 këtij zhvillimi të ri. Pse? Sepse sa i përket z. Kilaj, nuk ka
18 asgjë të re këtu. Ai, që nga fillimi është i vetëdijshëm për
19 provat që janë gjetur dhe sekuestruar nga shtëpia e tij më
20 datë 2 nëntor vitin e kaluar, dhe këtu po i referohem
21 materialeve të parashkruara në paragrafin 22 të versionit të
22 redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar.

23 Dhe që nga data 15 dhjetor e vitit të kaluar, data në të
24 cilën u parashtrua versioni i parë i aktakuzës për konfirmim,
25 që është po kjo ditë, ko incidencë, e parashtrimit të parë të

1 ZPS-së për rishikimin e paraburgimit, parashtrimin F00538 i
2 2018. Që nga data 15 dhjetor, z. Kilaj dhe Mbrojtja e tij janë
3 të vetëdijsëm për atë që di ZPS-ja lidhur me vizitën nga, tek
4 z. Thaçi më datë 6 tetor 2023. Transkripti i plotë i këtyre
5 regjistrimeve të kësaj vizite na janë nxjerrur neve. Edhe këtu
6 të gjitha këto janë publike. I referohem këtu paragrafit 20-21
7 të Aktakuzës së Konfirmuar.

8 Z. Kilaj, di, ka një vit që di atë që thotë ZPS-ja lidhur
9 me diskutimet që kanë të bëjnë me Dëshmitarin 003 dhe
10 Dëshmitarin 004.

11 Pra, është artificiale, ky është parashtrimi im, që të
12 bëhet një dallim, dallimin që ZPS-ja kërkon të bëjë. Dallimi
13 që z. Kilaj mund të ketë menduar në të kaluarën se kishte një
14 mundësi që ai të mos përballej me gjyq, por që tani ky rrezik
15 është bërë më konkret. Jo, në fakt kjo nuk është një, nuk
16 pasqyron realitetin.

17 Z. Kilaj ka ditur vazhdimisht që do të përballej me
18 gjykimin. Ai nuk ka pasur asnjëherë asnjë dyshim që nuk do të
19 konfirmohej në një moment të caktuar aktakuza kundër tij. Dhe
20 ka qenë gjithmonë e qartë lloji, natyra e veprave penale për
21 të cilat ai do të gjykohej, edhe akuza, vepra penale të sakta
22 mënyrat e përgjegjësisë të sakta, edhe pse pra, mënyrat,
23 veprat e sakta penale dhe mënyra e përgjegjësisë së saktë
24 penale është zbuluar, është bërë më e qartë kohët e fundit.

25 Ai ka ditur gjithmonë natyrën e dënimit që rrezikonte dhe

1 ka kuptuar gjithmonë që kjo mund të rezultonte në dënim me
2 burg afatgjatë. Kjo nuk ka qenë kurrë mister. Fakti që kjo
3 perspektivë është bërë më konkrete, në realitet nuk ndryshon
4 asgjë, në fakt. Kjo perspektivë në mendjen e tij ka qenë
5 gjithmonë e qartë dhe e pranishme.

6 Ai u deklarua i pafajshëm për të dy, për akuzat në
7 aktakuzë. Ne jemi, kemi besim se do të vërtetojmë që ai nuk
8 është penalisht përgjegjës për asgjë, por ndoshta po përsëris
9 veten. Nuk ka patur kurrë asnjë dyshim që do të mbahej gjykim.

10 Gjithashtu vlen të theksohet se çdoherë që Prokuroria bën
11 parashtime mbi domosdoshmërinë e vazhimit të paraburgimit,
12 nga data 15 dhjetor e vitit të kaluar, dhe pastaj përsëri më
13 12 shkurt të këtij viti, pastaj më 15 prill të këtij viti,
14 ZPS-ja thekson faktorët që sipas atyre vetëm mund të rrisin,
15 të shtojnë, motivimin e z. Kilaj për të ikur, për të penguar
16 ecurinë e procedurës, qoftë kjo zbulimi i provave të reja, apo
17 njohuria e z. Kilaj për aktakuzën apo aktakuzën e rishikuar,
18 parashtuar për konfirmim. Kjo është pjesë e strategjisë së
19 ZPS-së, klasike do të thoja.

20 Natyrisht, me kalimin e kohës, zhvillimet në këtë çështje
21 ndodhin dhe në veçanti, kur hetimet janë në vazhdim e sipër.
22 Ndërkohë që i dyshuari është në paraburgim. Dhe kjo është e
23 pashmangshme. Por ajo që ZPS-ja në mënyrë të pashmangshme ka
24 instrumentalizuar janë këto zhvillime, këto prova të reja.
25 Faktori i ri, pra, që është aktakuza e parashtuar për

1 konfirmim. ZPS-ja i ka gjithmonë instrumentalizuar këto
2 zhvillime për të argumentuar që, për të argumentuar arsyet për
3 mbajtjen e z. Kilaj në paraburgim.

4 Pra, mes nëntorit 2023 dhe majit të këtij viti, ZPS-ja
5 argumentoi se rreziku i ikjes dhe rreziku i pengimit është,
6 ishte bërë, po bëheshin gjithnjë e më të fuqishëm, dhe
7 gjithnjë më shumë të mundshëm. Dhe për rrjedhojë, arsyet e z.
8 Kilaj, motivimi i z. Kilaj për të ikur apo penguar, bëheshin
9 gjithnjë më të fuqishme. Dhe megjithatë, megjithatë, kur atij
10 iu dha kjo mundësi, kur ai u lirua me kusht, kur ai u vu në
11 provë, këto shqetësime u zhdukën. Dhe këto zhdukeshin.

12 Frika që kishte ZPS-ja, frika që kishte Gjykatësi i
13 Vetëm, rezultoi që të mos materializohej asnjë moment. Ai nuk
14 u fsheh. Nuk ndërhyri. Nuk bëri asgjë për të penguar
15 procedurën. Respektoi kushtet, qëndroi në shtëpi me familjen e
16 tij, vazhdoi jetën e tij, respektoi të gjitha kushtet me
17 besnikëri dhe në tërësi.

18 Dhe tani ZPS-ja thonë: Ah, po, kemi Aktakuzën e
19 Konfirmuar dhe rreziqet tani janë mjaftueshmërisht të mëdha që
20 justifikojnë heqjen e lirimit me kusht. Dhe është e vetmja.
21 Kjo është e justifikueshme për të injoruar vullnetin e tij të
22 vërtetuar për të përmbushur kushtet e lirimit me kusht. Dhe
23 këtë dua të trajtoj tani në një moment.

24 Në terma konkretë, çfarë ka ndryshuar: Ajo që ka
25 ndryshuar është, ndërkohë që përpar, "ishte vetëm dyshimi i

1 bazuar për përgjegjësinë penale” të z. Kilaj siç përkufizohet
2 nga neni 19 1.9 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, tani
3 kemi dyshimin e bazuar mirë siç është përkufizuar nga neni 19
4 1.12.

5 Unë nuk do të kundërshtoj apo argumentoj se standardi për
6 dyshimin e bazuar mirë nuk është më i lartë. Natyrisht që
7 është më i lartë. Por ajo që është absurde, që është
8 artificiale, sipas parashtrimit tim, është sugjerimi që z.
9 Kilaj nuk do të ikte, nuk do të ndërhynte në rrethanat ku
10 objektivi, ku një person që analizon në mënyrë objektive
11 situatën e hipotetimit, nuk do të ishte i bindur që ai ka më
12 shumë fajtorë krahasimisht me dyshimin e bazuar, me fjalë të
13 tjera ndoshta fajtor, 51 për qind, bazuar në një person që
14 hipotetikisht ka njohuri për këtë.

15 Tani po kalojmë në domenin, pra, të dyshimit të bazuar
16 mirë të fajësisë. Kur kalojmë këtu, befasisht, Prokuroria
17 sugjeron se ai, ka këtë motivim, befasisht, nga hiçi. Do të
18 lulëzon, del nga hiçi, ky motivim për të ikur apo për të
19 ndërhyrë që diçka ndodh në mendjen e tij. Duke kaluar nga një
20 standard në një standard më të lartë bazuar në posedimin, pra,
21 të provave të pranueshme që çojnë një vëzhgues objektiv me
22 terma konkretë, pra, ju vetë, në pikën ku bindet se ai është
23 fajtor në standardin, pra, mes 51 për qind. Pra, standardi
24 penal për dyshim, përtej dyshimit të arsyeshëm.

25 Këto janë dallime të rëndësishme për juristët, ndoshta.

1 Por, sipas parashtrimit tim është shumë jorealiste të mendohet
2 se kjo përbën një dallim kaq të madh për një person që nuk
3 është jurist, siç është z. Kilaj, i tillë që do të vepronte,
4 do të shkaktonte në mendjen e tij gjëra të tilla që ai
5 befasisht do të merrte, do të rrezikonte kaq shumë dhe do të
6 fshihej, do të ikte nga Kosova.

7 Çfarë do të thotë kjo? Çfarë do të thotë kjo në fakt për
8 një bashkëshort, baba, gjysh, që është rreth 61 vjeç?

9 Ky dallim, pra, mes dyshimit të bazuar dhe dyshimit të
10 mirë, të bazuar mirë, është i tillë që ai do të merrte, do të
11 rrezikonte që të shkatërronte jetën e tij, që të fshihej për
12 të gjithë jetën e tij. Të bëhet person në kërkim nga drejtësia
13 për gjithë jetën e tij. Për të humbur, duke humbur një shumë
14 të jashtëzakonisht të lartë që ka paguar për lirimin me kusht,
15 për të jetuar larg familjes, bashkësisë, familjes, gjithçka që
16 ka ndërtuar gjatë tërë jetës së tij. Apo ndoshta të bindte dhe
17 që gruaja të shkonte me të dhe të ndahej ajo nga familja e
18 saj. Për të hedhur gjithçka poshtë. Kjo është ajo që ZPS-ja ju
19 kërkon juve që të pranoni.

20 ZPS-ja sigurisht që do të, do t'ju referohet
21 jurisprudencës dhe të përpiqet t'ju bindë ju për dallimin e
22 këtij standardi, pra tani që është konfirmuar aktakuza. Dhe që
23 është aq e rëndësishme sa që thonë ata. Por unë po ju pyes,
24 shihni pak më thellë në këtë jurisprudencë, dhe pyeteni veten
25 çfarë do të thoshte kjo për një njeri si z. Kilaj.

1 Prokuroria thotë se pse tani standardi i dyshimit të
2 bazuar mirë është përmbushur dhe tani që ju mendoni që fajtor
3 në një standard më të lartë, diku në mes së drejtës, 51 për
4 qind, mes 51 përqindëshit dhe fajtor përtej dyshimit të
5 arsyeshëm. Ne sugjerojmë që nuk është realiste të bëhet një
6 dallim i tillë në mënyrë të tillë që dhe që kjo të shkaktojë
7 në mendjen e tij diçka të tillë që ai të rrezikojë të ikë nga
8 kjo procedurë, apo të kontaktojë dëshmitarë, apo të fshehë apo
9 të shkatërrojë prova. Ndërkohë që ju e dinit që ai ka patur
10 mundësinë dhe të gjitha mundësitë për ta bërë një gjë të tillë
11 po të kishte patur këtë synim, në çdo kohë gjatë shtatë muajve
12 të kaluar.

13 Kërkoj ndjesë për gjuhën që nuk është shumë formale, por
14 me gjithë mend? Është qëndrimi i Prokurorisë ajo që ju
15 kërkojnë të pranoni juve është absurde. Kjo nuk ka fare
16 kuptim. Është e pakuptimtë.

17 Nuk mund të jetë kjo e vetmja pikë ku merrni vendim dhe
18 t'i hiqni lirinë një personi i cili në mënyrë paqësore ka
19 jetuar në lirinë me kusht për shtatë muajt e kaluar, sepse
20 është e pabazë, dhe është e pabazë dhe si një tullë në një mur
21 që po shembet.

22 Z. Kilaj e ka ditur gjithmonë që do të vinte kjo
23 aktakuzë, por ZPS-ja thotë që kjo ndryshon çdo gjë. Dhe kjo
24 justifikon mbajtjen e tij në paraburgim. Prokurori e ka ditur
25 që do të ishte ky zhvillim që ta bindte z. Kilaj të burgosej.

1 Nuk ishin të kënaqur kur ai u lirua në mënyrë provizore. Nën
2 një, e bën apelimin më së koti.

3 Por, rëndësia e kësaj ndryshoi, mendojmë ne, dhe kjo
4 është iluzion. Mos i vini asnjë peshë, e nderuar Gjykatëse.

5 E nderuar Gjykatëse, juve në vendimin tuaj iu referuat
6 faktit që z. Kilaj ka dijeni për seriozitetin e veprave
7 konkrete për të cilat akuzohet. Unë duhet të them që kjo është
8 e pasaktë.

9 Pse e them këtë? Z. Kilaj e ka ditur gjithmonë që ishte
10 në rrezik të një dënimi, të një shpalljeje fajtor deri në pesë
11 vite sipas nenit 401(5) për një formë të agravuar të veprës.

12 Unë kam bërë kopje edhe për Prokurorinë. Nuk e di nëse
13 mund t'jua jap. Kam të disa dokumenteve.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Edhe për ZPS-në?

15 Z. EDWARDS: [Përkthim] Padyshim, edhe për ZPS-në.

16 Kam dy dokumente që kanë një J në krye në anën e djathtë,
17 dhe një që ka shenjën S për Prokurorinë.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. A mund për
19 procesverbal, a mund t'i paraqisni?

20 Z. EDWARDS: [Përkthim] I pari është kërkesa e parë e
21 Prokurorisë për vazhdimin e paraburgimit. Është parashtrimi me
22 numrin F00496, e 3 nëntorit 2023. Dhe tani, ju lutem, kaloni
23 në paragrafin 16 e këtij parashtrimi, ku thuhet:

24 "Kilaj ka dijeni që prova që mbështesin potencialisht
25 akuza të rënda të cilat mund të, për të cilat mund të dënohej

1 deri në pesë vjet, janë sekuestruar nga banesa e tij.”

2 Dhe në 4 nëntor 2023, gjatë paraqitjes së parë të tij,
3 Prokuroria ka thënë këtë, në seancë të hapur në transkriptin
4 me faqe 174.

5 “Z. Kilaj përbën rrezik arratie. Ai përballet me akuza të
6 rënda për sjellje penale për të cilat mund të dënohesh deri në
7 pesë vite. Ai ka stimuj, arsye të qarta për t’u, për të ikur
8 nga juridiksioni i Gjykatës duke përfshirë në shtete të treta
9 ku një kërkesë për ekstradim mund të mos pranohet.”

10 Ky argument është pranuar nga Gjykatësi i Vetëm në
11 arsyetimet e tij për vendimin për paraburgim të 9 nëntorit
12 2023, me numër F00503, paragrafi 36. Dhe pikërisht ai vendim
13 përbën dhe themelin e çdo zgjatje, vendime për zgjatjen e
14 mëtejshme të paraburgimit të tij.

15 Dhe dua të shtoj që ZPS-ja nuk e ka mbajtur ndonjëherë të
16 fshehtë faktin që personat zyrtarë që kryejnë detyra zyrtare
17 me, që lidhen me ato të z. Kilaj, me akuza ndaj z. Kilaj sipas
18 nenit 401, kanë qenë Gjykatës, Prokurorë, zyrtarë të Gjykatës,
19 të kësaj Gjykate. Kush tjetër, pyes unë në mënyrë retorike?
20 Cilët janë personat e tjerë të cilët ai i ka akuzuar, për të
21 cilët akuzohet se do t’i pengonte në kryerjen e detyrës?

22 Z. Kilaj gjithmonë e ka ditur se forma e rënduar e veprës
23 sipas nenit 401(5) është parashikuar nga ZPS-ja dhe se
24 Gjykatësi i Vetëm e dinte gjithashtu këtë. Për ta thënë se kjo
25 është përtej realitetit do të ishte thjesht, do të ishte

1 thjesht jo e saktë.

2 Por realiteti shkon përtej kësaj. Që nga konfirmimi i
3 aktakuzës kundër tij, z. Kilaj tani e di me saktësi se për
4 çfarë, çfarë rrezikon. Dhe realiteti është se ai përballet me
5 vepra të cilat, për të cilat mund të ketë një dënim më të ulët
6 se sa ka parashikuar fillimisht. Ai akuzohet për tentativë,
7 për ndihmë, si formë përgjegjëse në bazë të nenit 33, i cili
8 parashikon që një person që ndihmon duhet të, do të dënohet më
9 pak se sa autorit i drejtpërdrejtë i asaj vepre.

10 Pra, edhe nëse z. Kilaj dënohet, maksimumi prej pesë
11 vitesh nuk mund të qëndrojë si masë e arsyeshme për t'u dhënë
12 ndaj tij. E njëjta gjë mund të thuhet dhe në qoftë se dënohet
13 se ka pranuar të ndihmojë sipas nenit 35.

14 Edhe nëse z. Kilaj e di që këto vepra përbëjnë arsye për
15 t'u dënuar dhe për një kohë të gjatë, dijenia e tij për
16 dënimet e dhëna z. Gucati dhe Haradinaj, që ju i jeni
17 referuar, mund t'i shërbejnë vetëm faktit që ai mund të presë
18 një dënim më pak se sa katër vjet e tre muaj që ju është dhënë
19 atyre.

20 Gucati dhe Haradinaj janë dënuar shpallur fajtorë për
21 pesë pika, duke përfshirë vepra më serioze, më të rënda për
22 pengimin e drejtësisë me anë të kërcënimeve serioze sipas
23 nenit 401(1) dhe si udhëheqës apo organizues, organizatorë të
24 grupeve, sipas nenit 401(3), frikësim sipas nenit 387 dhe
25 shkelje të fshehtësisë së procedurës sipas versionit të

1 agravuar të nenit 392. Për këtë ata morën dënim katër vite dhe
2 tre muaj. Pra, kemi të bëjmë me një situatë krejt të ndryshme
3 nga ajo e z. Kilaj.

4 Që është situatë, që është, e tyre është shumë më e rëndë
5 se sa ajo për të cilën akuzohet z. Kilaj. Dhe e dyta, pika e
6 dytë për të cilët ai akuzohet tani, pra mosbindja e Gjykatës,
7 sipas nenit 393, është më e, më pak e rëndë se sa pika e dytë
8 e shkeljes së fshehtësisë së procedurave, që fillimisht është
9 dhënë, është menduar se do të bëhej ndaj tij. Sipas nenit 392,
10 gjë që do të kishte kërkuar një dënim deri në pesë vite, në
11 qoftë se do të shpallej fajtor për këtë formë të agravuar.
12 Atëherë do të ishte maksimum pesë vjet. Plus faktin që ai ka
13 ndejtur në burg gjashtë muaj, dhe kjo gjë duhet mbajtur në,
14 parasysh.

15 Që ta përmbledh, ajo që ai akuzohet në Aktakuzën e
16 Konfirmuar e bën të qartë që ai është, dhe të sigurt që ai
17 është në një rrezik të vogël se sa mendohej fillimisht, gjë që
18 parashikonte dhe dënim me gjasa më të vogël.

19 Kjo nuk përbën një stimul më konkret për t'u fshehur, siç
20 pretendon Prokuroria. Ai këtë stimul mund ta ketë pasur
21 gjithnjë, por vendimi i konfirmimit në fakt realisht nuk
22 ndryshon asgjë.

23 Përkundrazi, z. Kilaj duhet të përfitojë nga ato që ka
24 treguar dhe që është provuar se dhe pse mund të ketë një
25 stimul apo motiv dhe mjete, dhe mundësi, që nga lirimi i tij

1 në maj ai nuk është fshehur. Nuk ka penguar gjë, nuk ka
2 ndërhyrë.

3 Më parë është konstatuar se dijenia që ka pasur ai për
4 ekzistencën e një aktakuze kundër tij, dhe ideja e përballjes
5 me akuza penale, do t'i kishte bërë rreziqet e fshehjes më
6 shumë, më të larta, por ai u lirua dhe këto rreziqe nuk u
7 materializuan asnjëherë.

8 Dhe unë parashikoj, unë parashtroj që kjo është, ky është
9 një faktor tepër, jashtëzakonisht i rëndësishëm për ta marrë
10 parasysh. Nuk është një fakt që mund të lihet mënjanë me
11 lehtësi. Sepse ZPS-ja i bie të njëjtës histori, luan të
12 njëjtën muzikë të vjetër, dhe argumenton se ai është njeri që
13 nuk mund t'i besohet sepse ka prova që demonstrojnë
14 gatishmërinë e tij për të keqpërdorur informacionin e Gjykatës
15 dhe se, për ta përdorur atë siç mund të mendohet, pa marrë
16 parasysh rregullat e konfidencialitetit.

17 Pra, kjo gjë duhet të vihet në, duhet të vihet në balancë
18 nga kjo Gjykatë.

19 Në gjashtë, në shtatë muajt e fundit ai ka respektuar të
20 gjitha urdhrat e Gjykatës. Ka treguar gatishmëri të plotë dhe
21 aftësinë e plotë për t'u, për të respektuar plotësisht
22 rregullat. Nuk ka bërë asnjë hap të gabuar.

23 Në qoftë se kishte një ide që ai ka penguar gjë procesin,
24 në qoftë se do të kishte bërë diçka të gabuar, në qoftë se do
25 të ishte përpjekur të ndërhynte në çfarëdo lloj mënyre,

1 sugjeroj që mendoj që ju duhet ta kishit ditur.

2 Ju mundeni dhe duhet të peshoni, të vini në peshore,
3 sjelljen e kohëve të fundit të tij që i është përmbajtur të
4 gjitha kushteve. Dhe unë sugjeroj që kjo tregon shumë dhe kjo
5 duhet të kundërveprojë ndaj asaj që thotë, duhet të jetë më me
6 peshë se ato që thotë Prokuroria.

7 Fakti që atij i është dhënë mundësia dhe që ka
8 respektuar, është diçka që unë do të thoja ky institucion
9 duhet të ishte i kënaqur me një gjë të tillë.

10 Unë parashtroj që nuk mund të injorohet që ajo, që ai me
11 të cilin akuzohet, nuk mundet të provojë se ai vërtet do të
12 fshihej, do të pengonte procesin. Në qoftë se do të kishte
13 pasur ndonjë provë që ai ka penguar procesin gjatë shtatë
14 muajve të fundit, ju do ta kishit mësuar.

15 Pra, nuk ka fare bazë të besohet se situata ka ndryshuar
16 dhe se befas përballëmi me një risk më të madh për shkak të
17 konfirmimit të aktakuzës.

18 E nderuar Gjykatëse, ju mbase mendoni sepse në vendimin
19 tuaj thatë që përmbushja e rregullave në të kaluarën nuk është
20 bazë me eliminimin e rrezikut. Unë pajtohem me këtë sigurisht.
21 Por e nderuar, rreziku nuk mund të eliminohet asnjëherë
22 plotësisht kur një person është i liruar me kushte. Një
23 Gjykatës i Vetëm që i dha lirinë, e pranoi faktin që gjithmonë
24 ekziston një rrezik.

25 Por pyetja që shtrohet është realisht: Jeni të gatshëm

1 t'i jepni një besim z. Kilaj? Gjë që ia dha Gjykatësi i Vetëm,
2 kur e liroi.

3 Për sa i takon sugjerimit që ai mund të prekë, mund të
4 prekë provat, mund t'i manipulojë provat, është diçka e
5 çuditshme. Prokuroria nuk thotë që i ka manipuluar apo që ka
6 fshehur ndonjë provë që kur është liruar me kusht. Prokuroria
7 nuk sugjeron aspak se çfarë lloji provash rrezikohet që të
8 manipulohen. Sepse nuk ka një provë të tillë, dhe Prokuroria e
9 di mirë.

10 Nuk ju kërkoj, e nderuar, që t'i besoni, që t'i jepni z.
11 Kilaj një shans, një mundësi në mënyrë të pakushtëzuar, por ju
12 bëj thirrje të konstatooni që është një kandidat i mirë për t'u
13 liruar me kusht dhe për t'i vendosur të njëjtat kushte që u
14 vendosën atij nga Gjykatësi i Vetëm dhe të cilat ai i ka
15 përmbushur.

16 Është e hapur për ju, që të vini sigurisht edhe kushte të
17 tjera në qoftë se do të mendonit që zhvillimet gjatë javëve të
18 fundit kanë, përbëjnë një ndryshim. Ju mund ta urdhëroni z.
19 Kilaj të raportojë përpara stacionit, në stacionin e policisë
20 më shumë se një herë në javë. Mund të mos e lejoni të udhëtojë
21 më shumë se sa larg shtëpisë së tij në Malishevë. Mund ta
22 urdhëroni që të mos përdorë asnjë mjet komunikimi përveçse për
23 të komunikuar me Avokatin e tij. Gjë që mbase edhe nuk është
24 shumë praktike.

25 Por mund t'ju them, kam folur me familjen e z. Kilaj, dhe

1 mund t'ju them që ata mund të paguajnë dhe më shumë për
2 dorëzaninë nga 30,000 në 40,000 euro. Nuk do të jetë e lehtë
3 për ta. Z. Kilaj nuk është i pasur. Familja e tij nuk është e
4 pasur. Por familja dhe familja e zgjeruar janë të gatshëm të
5 kontribuojnë, të bëjnë sakrifica, që të mbledhin një shumë kaq
6 të madhe parash. Janë të gatshëm ta bëjnë një sakrificë të
7 tillë sepse i besojnë z. Kilaj.

8 Njohuria nga ana e z. Kilaj se një sasi kaq e madhe
9 parash do të humbiste në qoftë se ai do të fshihej, ose të
10 konstatohej se ka penguar procesin, njohuria e një humbjeje të
11 tillë do të shërbente si një faktor për ta zhbundur ose për të
12 mos e lejuar z. Kilaj të bënte ndonjë nga këto veprime.

13 Dua që në përfundim të them që është parashikuar
14 gjithmonë nga Gjykatësi i Vetëm se z. Kilaj mund të vazhdonte
15 të ishte i lirë mbas konfirmimit të aktakuzës. Është
16 parashikuar, prandaj është vënë edhe ky kushti që të merrte
17 pjesë në çdo seancë që do të kërkonte Gjykata. Dhe të
18 informonte Zyrën Administrative për çdo adresë që do të kishte
19 në shtetin pritës.

20 Po t'i ishte dhënë kjo mundësi të udhëtonte në Holandë,
21 të vinte përpara Gjykatësve, nëse do të thirrej, ai do ta
22 kishte bërë një gjë të tillë. Por t'i kishit dhënë rastin,
23 mundësinë, të provonte gatishmërinë e tij për të bërë atë që
24 do të urdhërohej të bënte, ai do ta kishte bërë dhe do ta
25 kishte bërë me gjithë qejf. Atij nuk iu dha ky rast.

1 Dhe ngjarjet e ditëve të fundit e kanë tronditur, kanë
2 tronditur atë, familjen e tij. Ai dhe të gjithë në familjen e
3 tij e kanë pranuar gjithmonë faktin se do të kishte një gjyq,
4 janë të përgatitur për këtë, dhe janë më se të përgatitur që
5 ta lejojnë drejtësinë të ecë përpara. Por, ajo që sinqerisht
6 ishte disi e papritur, ishte fakti që do të arrestohej, që
7 lirimi me kusht do të kthehej mbrapsht dhe se ai do të mbahej
8 në paraburgim në pritje të gjykimit.

9 Atë e tmerron kjo ide, e kalimit dhe një ditëlindje
10 tjetër që e ka javën e ardhshme të mbyllur në burg, një
11 Krishtlindje dhe një vit të ri të dytë.

12 Ditët e fundit në Hagë, në paraburgim, kanë qenë një
13 kujtesë e tmerrshme për të lidhur me atë që do të ndodhte nëse
14 do të bënte një veprim të gabuar në të ardhmen. Që nga maji
15 nuk ka bërë asnjë hap të gabuar, ai i është dhënë rasti, e ka
16 provuar se ishte i besuar dhe ne thjesht ju kërkojmë që t'ia
17 jepni përsëri këtë rast që t'i besoni, sepse ai e meriton.

18 Këto ishin parashtrimet e mia, e nderuar Gjykatëse, në
19 qoftë se keni ndonjë gjë tjetër, pyetje, mund të m'i bëni.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Nuk kam pyetje në këtë
21 moment.

22 Tani ia jap fjalën Prokurorit të Specializuar.

23 Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

24 Shkurt do t'i përgjigjem disa nga pikat që ngriti
25 Avokati.

1 E vërteta është se z. Kilaj, siç është këtu, në bazë të
2 provave të mbledhura dhe akuzave që ju, e nderuar, i
3 konfirmuat, e vërteta është që ai përbën një rrezik për
4 funksionimin e këtij institucioni. Nuk do të shtjelloj të
5 gjitha konstatimet që ju keni bërë.

6 Paragrafi 36 deri në 38 [Sipas përkthimit] të vendimit
7 tuaj F0037 janë të mirë arsyetuara, të artikuluar, dhe të
8 mbështetura në fakte. Pothuajse gjithçka që Avokati shprehu
9 janë artikuluar dhe trajtuar në vendimin tuaj. Dhe nuk do t'i
10 përsëris, thjesht në disa pika që mendoj se duhen vënë në
11 dukje.

12 Pohimi i përsëritur mbi dhjetë herë se z. Kilaj në
13 mendjen e tij subjektive, pavarësisht se si është formuluar në
14 tru, e ka ditur se do të kishte akuza të tilla kundër tij, nuk
15 ka kuptim, lidhur me, në kontekstin e këtyre që po themi.

16 Deri tani nuk ka pasur akuza të konfirmuara.

17 Ne jemi këtu, jemi në një vend që ka rregulla. Dhe
18 rregulli është që ju apo Gjykatësi i Procedurës Paraprake
19 duhet ta konfirmojë një akuzë përpara se të bëhet e tillë. Po
20 të kthehemi në nëntorin e 2023 kur u arrestua z. Kilaj dhe
21 qëndroi, ishte në këtë dhomë, dhe u përfaqësua nga z. Edwards,
22 duke thënë që asnjë nga provat që paraqiti Prokuroria
23 meritonte paraburgim apo akuza, sepse ishin thjesht përskrime
24 të singerta. Ai nuk kishte si ta dinte atëherë, sepse në
25 mendjen e tij nuk kishte asgjë për të akuzuar, s'kishte bërë

1 asgjë të gabuar.

2 Tani jemi në një vend tjetër, praktikisht dhe ligjërisht.
3 Ai tani e di se ka akuza të mëdha kundër tij dhe janë të
4 konfirmuara.

5 Një gjë tjetër që ju e trajtuat po që dua ta theksoj dhe
6 një herë. Z. Kilaj nuk u lirua nga bazë të idenë që të besohej
7 apo t'i jepej mundësia të lirohej, sigurisht me kundërshtimin
8 tonë. Por për shkak të vonesës së procesit, për shkak të
9 proporcionalitetit se sa duhej mbajtur, përpara se të fillonte
10 gjykimi. Kjo iku, tani jemi në një situatë tjetër. Ju i keni
11 konfirmuar akuzat, dhe tani jemi futur në rrugë për të drejtë
12 gjykimi të z. Kilaj dhe bashkautorëve.

13 Jemi dakord që gjykimi duhet të jetë, të bëhet sa më
14 shpejt, por e vetmja arsye që u lirua ishte jo, dhe nuk
15 ekziston më. Nuk e bënë që t'i jepej, që të bëheshim të mirë
16 apo t'i jepnim një rast. Pra, nuk ekziston më kjo gjë.

17 Z. Kilaj ka demonstruar jo me fjalët tona, por me fjalët
18 tuaja në vendim për të shpërfillur rregullat e këtij
19 institucioni. Kjo gjë është rritur shumë që nga koha e fundit
20 që ai ishte këtu, gjë që nuk është trajtuar nga Avokati i tij
21 dhe nuk ka problem. Por ai ka pasur, ai ka pasur materiale
22 konfidenciale të dëshmitarëve. Ai nuk mund të besohet me
23 materialet e reja që do të marrë, apo që kishte, nuk i besojmë
24 dot.

25 Koncepti që u vu në dukje disa herë këtu është e paqartë

1 se përse dikush do të sugjeronte që ai, z. Kilaj, përbën një
2 rrezik për ikje. Kur neve shkua në shtëpinë e tij në çantën e
3 tij gjetëm shumë dokumente të dëshmitarëve. Këtë e kemi vënë
4 re, në dukje dhe në materialin tonë.

5 Z. Kilaj përbën rrezik të qartë për arrati, për pengimin
6 e këtij procesi dhe unë parashtroj që ai paraqet rrezik ende
7 për procese të tjera në vazhdim në këtë institucion, që
8 mbështeten në numrin e madh të provave të gjetura, që tregon
9 që jo vetëm se ai është përpjekur më përpara të pengojë
10 procesin, por se nuk e ka asnjë konsideratë për këtë vend, për
11 rregullat e tij apo për të funksionuar sipas rregullit. Asnjë
12 nuk ka.

13 Pra, e nderuar, nuk kam gjë tjetër për të shtuar përveçse
14 nëse keni ju pyetje. Që të jemi të qartë, vendimi juaj i ka
15 trajtuar në mënyrë efektive të gjitha këto. Parashtrimi ynë e
16 bën të qartë se në bazë të tre faktorëve, jo një e dytë, por
17 të treve, paraburgimi i z. Kilaj është i nevojshëm.

18 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.

19 Prokuror.

20 Mbrojtja ka diçka për të thënë?

21 Z. EDWARDS: [Përkthim] Shumë shkurt.

22 Po. Ju keni dhënë një vendim. Po, e keni konstatuar se ka
23 arsye për ta mbajtur z. Kilaj në paraburgim, por këtë vendim
24 ju e morët pa dëgjuar parashtrimet tona, prandaj edhe ne jemi
25 këtu.

1 Kolegu i nderuar sugjeron që kur z. Kilaj ishte këtu
2 nëntorin e vitit të shkuar, ai tha që ka një shpjegim të qartë
3 pse ishte këtu. Kjo është një budallallëk. Një i pandehur që
4 arrestohet dhe vjen në gjyqësore mund të thotë shumë mirë në
5 paraqitjen e tij të parë, "E godita një burrë", për shembull,
6 "për vetëmbrojtje". Apo, "Nuk kisha ndërmend që personit t'ia
7 hiqja ato që ai pretendon" personi mund të thotë që, "Unë kam
8 një mbrojtje për veprimin tim", por nuk do të thotë që nuk do
9 të ketë një gjyq ndaj atij personi.

10 Kolegu im i nderuar thotë që z. Kilaj nuk mund t'ia kesh
11 besën, nuk mund t'i besosh sepse iu gjet shumë material
12 konfidencial. Ajo për të cilën ai nuk akuzohet, sepse nuk mund
13 ta akuzojnë, është që ai, që nuk bëri asgjë me atë material.
14 Ju lutem, mos e harroni këtë gjë. Ai mund ta ketë pasur në
15 zotërim materiale që nuk, prova që nuk duhet t'i kishte, por
16 thjesht i kishte aty, në kompjuter dhe nuk ka çuar gjëkund.
17 Këtë gjë duhet ta merrni parasysh kur të vendoset se sa i
18 rrezikshëm është z. Kilaj.

19 Kaq kisha për të thënë.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

21 Tani do të bëjmë një pushim, gjatë të cilit do të
22 shqyrtoj parashtrimet tuaja dhe do të lëshoj një urdhër me
23 gojë për këtë çështje sot.

24 Përpara asaj, dua të di nëse ka ndonjë çështje tjetër që
25 palët dëshirojnë të ngrenë?

1 Z. EDWARDS: [Përkthim] Nuk e di nëse ka ardhur në
2 tavolinën tuaj, por mund t'ju them se dje unë dorëzova
3 tërheqjen e kërkesës sime për një datë të synuar për
4 konfirmim. Në rrethanat që jemi tani ajo nuk, është e
5 tejkaluar dhe është ai që në mënyrë zyrtare, ka numër 805.

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E mora shënim.

7 Në qoftë se nuk ka ndonjë çështje tjetër që palët
8 dëshirojnë të ngrenë, tani do të bëjmë një pushim prej një
9 ore. Pra, tani është 14.15, do të rimblidhemi në orën 15.20.

10 --- Seanca ndërpritet në orën 14.15

11 --- Seanca rifillon në orën 15.23

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Rifillojmë seancën. Për
13 procesverbalin, theksoj se të gjitha palët e përfaqësuesit e
14 Zyrës Administrative janë në sallë të gjyqit.

15 Tani do të lëshoj urdhrin gojor në lidhje me paraburgimin
16 e z. Kilaj.

17 Mbrojtës Edwards, kam marrë parasysh kërkesën tuaj për
18 lirimin e z. Kilaj me kushtet, si ato të përcaktuara në
19 vendimin KSC-BC-2018-01, F00658/COR të datës 3 maj 2024, dhe
20 çdo kusht tjetër shtesë.

21 Kam marrë parasysh parashtrimin në lidhje me sjelljen e
22 dëshmuar të z. Kilaj gjatë shtatë muajve të kaluar, se atij
23 mund t'i besohet dhe se në mënyrë -- dhe me besnikëri dhe në
24 mënyrë pozitive i ka përmbushur të gjitha kushtet e caktuara.
25 Ju nënvizoni se z. Kilaj nuk është arratisur, nuk ka penguar

1 procesin, dhe nuk i ka përsëritur veprat penale gjatë lirimit
2 me kusht. Gjithashtu mbaj parasysht pretendimin tuaj se
3 konfirmimi i aktakuzës dhe fillimi i procedurës paraprake nuk
4 ndryshojnë rrethanat e z. Kilaj.

5 Sa i përket ekzistencës të tre rreziqeve sipas nenit
6 41(6)(b) të Ligjit, ju parashtrova fillimisht se z. Kilaj ka
7 dijeni që një vjet lidhur me pretendimet faktike dhe ligjore
8 të ZPS-së, të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar dhe me
9 dënimin e mundshëm me burgim të gjatë. Ju theksoni veçanërisht
10 se vërtetimi i dyshimit të bazuar mirë në këtë fazë, nuk e
11 motivon z. Kilaj për t'u arratisur. Ju gjithashtu argumentoni
12 se z. Kilaj nuk do të mirrte rrezikun e pengimit të procesit
13 nëpërmjet, për shembull, kontaktimit të dëshmitarëve apo duke
14 fshehur provat apo i shkatërruar ato, duke pasur parasysht ai
15 ka pas këtë mundësi dhe çdo mundësi tjetër për ta bërë këtë
16 gjatë shtatë muajve të kaluar. Në këtë kontekst, ju gjithashtu
17 nënvizoni se edhe pse z. Kilaj mund të ketë pas në posedim
18 material konfidencial, ai atë asnjëherë nuk e ka përdorur.

19 Ju gjithashtu argumentoni se z. Kilaj është vetëdeklaruar
20 i pafajshëm dhe është i vetëdijshtë se do të vazhdojë gjykimi.
21 Ju gjithashtu kërkoni që unë të marr parasysht që z. Kilaj nuk
22 akuzohet për pengim të drejtpërdrejtë.

23 Kam marrë gjithashtu parasysht qëndrimin e Prokurorisë se
24 kërkesa e z. Kilaj për lirim me kusht duhet të hidhet poshtë
25 dhe se ai duhet të mbahet në paraburgim. ZPS-ja argumenton se

1 të gjitha rreziqet ekzistojnë. Sipas ZPS-së z. Kilaj paraqet
2 një rrezik të qartë dhe aktual për punën e Dhomave të
3 Specializuara. ZPS-ja thekson se këto rrethana kanë ndryshuar
4 sepse: Një, aktakuza është konfirmuar vetëm me datë 29 nëntor
5 2024, kurse z. Kilaj nuk ka pasur dijeni për ato akuza në
6 kohën e paraburgimit dhe lirimit të tij me kusht; e dyta, z.
7 Kilaj u lirua mbi bazën e proporcionalitetit për shkak të
8 vonesës së panevojshme të hetimit, që nuk qëndron më në ditën
9 e sotme; dhe se z. Kilaj ka pas në posedim material
10 konfidencial dhe do të merr material të tillë me ecurinë e
11 çështjes.

12 Pasi kam shqyrtuar të gjitha argumentet e palëve, asgjë
13 nuk ndryshon vlerësimin tim se kushtet e përcaktuara në nenin
14 41(6) vazhdojnë të përmbushen, sikurse përcaktohet në vendimin
15 tim për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe për Çështje në Lidhje
16 me to, që është parashtrimi F000037, paragrafi 43 dhe
17 paragrafët 56 deri në 67.

18 Konkretisht nuk jam bindur se z. Kilaj nuk paraqet rrezik
19 arratisje duke mbajtur parasysh sjelljen e tij në të kaluarën,
20 për arsyet e parashtruara në paragrafin 57 deri në 60 të
21 vendimit të posapërmendur. Mbetem e bindur se ekziston rreziku
22 i arratisjes. Në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes,
23 Aktakuza e Konfirmuar tani i ngarkon z. Kilaj akuza konkrete.
24 Rrjedhimisht, ai do të vazhdojë të marrë tërësinë e provave në
25 këtë çështje gjyqësore që do t'i japë atij një motiv shtesë

1 për t'u arratisur. Fakti që z. Kilaj ka lidhje familjare në
2 Kosovo -- në Kosovë, vetëm ul pjesën pjesërisht këtë rrezik,
3 por nuk e eliminon plotësisht atë.

4 Për sa u përket rreziqeve të pengimit të procedurës
5 penale dhe përsëritjes së veprës penale, unë iu referohem
6 konstatimeve në paragrafët 61, 66 të Vendimit për Lëshimin e
7 Fletarrestimit dhe konstatoj se këto rreziqe vazhdojnë të
8 ekzistojnë për arsye të njëjta që i përmenda dhe në lidhje me
9 rrezikun e arratisjes.

10 Prandaj, duke -- pasi kam marrë parasysh të gjitha
11 parashtrimet e palëve, vendos që z. Kilaj të mbetet në
12 paraburgim.

13 Arsyet për paraburgimin tuaj, z. Kilaj, janë të njëjta si
14 ato të përcaktuara në Vendimin për Lëshimin e Fletarrestimeve,
15 paragrafët 43 dhe paragrafët 56 deri në 67, të cilat duhen
16 lexuar së bashku me këtë urdhër gojor.

17 Rrjedhimisht, bazuar në informacion dhe materialet mbi të
18 cilat bazohet vendimi 37 dhe në mungesë të informacionit apo
19 zhvillimeve që i kundërshtojnë ato konstatime, konstatoj: e
20 para, se ekziston dyshimi i bazuar mirë se ju mbani
21 përgjegjësi penale për veprat penale për të cilat u informuat
22 sot; dhe, e dyta, ekzistojnë arsye të artikulueshme për të
23 besuar se ju përbëni rrezik arratisje, se ju do të pengoni
24 ecurinë e procedurës penale dhe se ju do t'i përsëritni veprat
25 penale.

1 Gjithashtu, asnjë prej kushteve që propozoni ju,
2 Mbrojtësi Ewards, siç është dorëzania prej shumës prej 40,000
3 eurosh, paraqitja më e shpeshtë tek autoritetet policore
4 kosovare dhe kufizimi i komunikimeve dhe lëvizjeve të z.
5 Kilaj, janë të afta apo adekuate për uljen e këtyre rreziqeve.

6 Së fundi, konstatoj se paraburgimi i z. Kilaj është
7 proporcional, me gjithë paraburgimin e tij prej datës 2 nëntor
8 deri më 15 maj të vitit 2024, duke mbajtur parasysh dënimin e
9 mundshëm me të cilën ballafaqohet.

10 Z. Kilaj, do t'i rishikoj arsyet për mbajtjen tuaj në
11 paraburgim brenda dy muajsh ose në një moment më të hershëm me
12 kërkesë të palës ose me ndryshim të rrethanave, sikurse
13 përcaktohet në nenin 41(10) dhe rregullën 57(2) të
14 Rregullores.

15 Ju, i nderuar Mbrojtës, në qoftë se doni të parashtroni
16 parashtrimet tuaja në lidhje me rishikimin e ardhshëm të
17 paraburgimit, këtë mund ta bëni deri të mërkurën me 15 janar
18 2025. Përgjigjet dhe kundërpërgjigjet do të bëhen brenda
19 afateve të parapara në rregullën 76 të Rregullores.

20 Në qoftë se Mbrojtja vendos të mos bëjë parashtrime
21 brenda afatit të lartpërmendur, urdhëroj ZPS-në që t'i bëjë
22 parashtrimet e veta në lidhje me paraburgimin e z. Kilaj, deri
23 të martën 21 janar 2025. Mbrojtja mund t'i përgjigjet atyre
24 parashtrimeve në qoftë se dëshiron deri të martën, 28 janar
25 2025. Nuk do të shqyrtoj kundërpërgjigje.

1 Së fundi, z. Kilaj, ju keni të drejtën ta apeloni këtë
2 vendim për paraburgimin tuaj drejtpërdrejtë përpara Gjykatës
3 së Apelit brenda 10 ditësh, sikurse përcaktohet në nenin 45(2)
4 të Ligjit dhe rregullat 58 dhe 170 të Rregullores.

5 Me kaq përfundon urdhri im gojor.

6 Dhe këtu përfundon dhe seanca e sotme. Falënderoj të
7 gjitha palët për pjesëmarrjen e tyre dhe praninë e tyre në
8 këtë seancë, si dhe të gjithë ata që e mundësuan realizimin e
9 kësaj seance.

10 --- Seanca e paraqitjes së parë mbyllet në orën

11 15.33

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25